

O.J.F “URDHRI I PSIKOLOGUT” TIRANE

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

PËR

PERIUDHËN

1 JANAR - 31 DHJETOR 2021

Tiranë , 24 MARS 2023



"Muca Auditing" sh.p.k
NUT L814060441,
Cel. 069 4092435,
e-mail : mucalindita@yahoo.com

Faqe 1

RAPORTI

I

EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor 2021
të O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT" TIRANE

Drejtuar : **Znj, Valbona Treska** Perfagesues Ligjor i O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT"

TIRANE

Kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkëlidhur të Shoqërisë "O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT", të cilat përmbajnë : **Bilancin** kontabël, **Pasqyrën** e të ardhurave dhe shpenzimeve, **Pasqyrën** e Flukseve Monetare (Cash Flow), **Pasqyrën** e levizjes së kapitaleve dhe **Shënimet** shpjeguese për ushtrimin e mbyllur më datë 31 Dhjetor 2021.

Përgatitja dhe paraqitja e sinqertë e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet e raportimit financiar është përgjegjësi e Drejtimit të shoqërisë. Kjo përgjegjësi përfshin : hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare që ato të mos përmbajnë anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël si dhe çmuarje kontabël të arsyeshme për rrethana të dhëna.

Përgjegjesia jonë është që, bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare.

Kemi kryer auditimin në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit.

Këto standarte kërkojnë që në procesin e auditimit të zbatohen kërkesat etike dhe auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështetet në shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve

"Muca Auditing" sh.p.k
NUIŠ L81406044I,
Cel. 069 4092435,
e-mail : mucalindita@yahoo.com



Faqe 2

për anomali materiale në pasqyrat financiare për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përcaktimin e vlerësimeve të rrezikut auditusi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm të shoqërisë në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të shoqërisë.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe llogjikën e çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të Pasqyrave Financiare.

Besojmë se evidenca e auditimit e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përgatitura me një besueshmëri të arësyeshme japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjëndjet financiare të Shoqërisë "O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT"", më 31 Dhjetor 2021, të rezultatit financiar, të levizjes monetare (flukseve të parasë) dhe të levizjes së kapitaleve në pajtim me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr.25 date, 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit .

Lindita Muça

Tirane,24.03.2023

Auditues Ligjor(EKR)

